



ZYRA E KRYETARIT

01-351-7081/2025

11.03.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik , në bashkëpunim, dhe propozim të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, merr këtë:

V E N D I M

Për

Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Caktohet Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Ndërtimi i infrastrukturës nentokësore dhe mbitokësore në Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë-Zabergjë** , me operator "Rea" SH.P.K Klinë.

Me numër të prokurimit: **634-25-889-5-3-5/C836** dhe me numër te biznesit **811242502** të datës 11.03.2025, plani për implementimin e kontratës është 3 muaj.

Vlera e kontratës është 7.996.50 Euro

- I. VIISAR I BOJA Menaxher i kontratës (Udhëheqës i ekipit) caktohet:
Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____
- ARJETA DODAJ Menaxher i kontratës caktohet:
Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____
- ELVIS PERLLESHAJ Menaxher i kontratës caktohet:
Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet:

II. **Enver Berisha**, Drejtor në Drejtorinë për Urbanizem.

1. **Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës** obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe emërimit të Menaxherit të kontratës (MK) të gjitha përgjegjësitë përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek Menaxheri i Kontratës.

2. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i kontratës do të:

- a. menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
- b. sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë dhe
- c. bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontratës janë:

- a. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- b. Menaxheri i kontratës, duhet të lexoj kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- c. Të dorëzoj Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyre të prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerr urdhër blerjen;
- d. Pas pranimit të urdhër-blejes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkoj në platformën elektronike urdhër-blejen dhe të përcjell të njëjtën përmes platformës tek OE, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- e. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f. Të sigurojë që Operatori ekonomik të dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- g. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

- h. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- l. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin;
- m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- n. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi dhe
- o. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontratë siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

3. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
- b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit - vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ .

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Prokurimit;
- Menaxherit të kontratës;
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës;
- Njësisë së Kërkesës;
- Arkivit të Komunës.

ZKA – KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINË

Zyra e prokurimit

Nr. 354-708.1/25

DATE 11.03.2025

KONTRATË NR 06-2025

Numri i kontratës:¹ 634-25-889-5-3-5/C836

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

" REA" SH.P.K., ABEDIN REXHA, KLINË, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Punë shtese ne Projektin Ndertimi i infrastruktures nenetoksore dhe mbitokesore në Gllareve- Rixheve- Stapanicë-Zabergjë me numër identifikues: 634-25-889-5-3-5

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Punë shtese te cilat nuk jane parapare perperfundim te projektit**

No.	Lot
1	Punë shtese ne Projektin Ndertimi i infrastruktures nenetoksore dhe mbitokesore në Gllareve- Rixheve- Stapanicë-Zabergjë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **7,996.50 €**; Shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë Euro e pesëdhjetë Cent.

2.2 Plani dinamik është 20 dite.

2.3 sigurimi i ekzekutimit do te jete **799.65 Euro** me validitet 20 dite + 30 dite = 50 dite

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Ne baze te situacioneve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Organi Mbikëqyrës dhe Fature

- Mbajtja e parasë ne vlere 799.65 € do te paguhet pas Afatit te garancionit te punimeve mbas 12 muajve pas pranimit te përkohshëm teknik. Kjo mund te paguhet me garancion nëse ekzistojnë mjetet ne dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	11.03.2025
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	REA SHPK - Gentiana Milkku
Pozita:	Person i autorizuar
Nënshkrimi:	
Data:	11.06.2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

ASFALTIMI I RRUGËVE : NË FSHATIN GLLAREVE RIXHEVE STAPANICE ZABERGJE

PUNËT SIHTESE

PUNËKRYERSE: REAshpk

NR. UNIK: 811242502

1. PARAMASA PËR ASFALTIMIN E RRUGËS SIPAS SITUACIONIT TË RRUGËVE TË SPECIFIKUAR NË PROJEKT (PJESA GRAFIKE)

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Cmimi njësi (€)	Cmimi total me TVSH (€)
------------	--------------------------	--------	-------	-----------------	-------------------------

Te gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standartet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punuesit me mjetet sinjalizuese para fillimit të punës, nëqytet zonën ku do të zhvilloj aktivitetet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntokësore tëqytetarve është e obliguar si keqeje në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare.

1 PUNËT PARAPRAKTE					
1.1	Mobilizimi i ndërmjetës për aktivitetet, vendosja e shenjave për sigurim të komunikacionit për aktivitetet e punës në rrugë, në bashkëpunim me menaxherin e projektit. Te dhënat :L=1000.00 m ² , b=2.8-3.0 m ² ; Te dhënat :L=250.00 m ² , b=4.0 m ² bankinat 2x0.30m , kanal për ujërat atmosferik 1m në të dy anët ku ka leshesa. Llog m ²	m	0.00	5.00 €	0.00 €
1.2	Shenimi i trasës, si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit duhe i trajtuar edhe elemente përcjellëse të rrugës si : Kyçja e rrugëve dytësore , interceptimi (kryqëzimi) në bazë të projektit zbatues, në majet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përsëritura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, Llog në m ² Majet gjeodezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët e kryera të sjelljen hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjeodet të lincencuar.	m	0.00	0.10 €	0.00 €
Gjithsej: Pos 1					

2 PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT					
2.1	Pastrimi i terrenit largimi i drunjëve, shkurret dhe rrethojave me tela xhemboze dhe mbeturinat apo gjësendet tjera të ngurta që e pengojnë gjatë ekzekutimit të rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjërësi të përcaktuar me projekt sipas profilit tërthorë si dhe largimin e tyre në deponi më të afërta. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rrethojave dhe këmbin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Llog në m ² .	m ²	0.00	0.10 €	0.00 €
2.2	Dislokimi i infrastrukturës nëntokësore (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonike dhe internetit) , në trasen e rrugës ku zhvillohen punimet e rrugës , zhvendosja e tyre jashtë rrugës në koordinim me institucionet përgjegjëse si KEDS , PTT , ujësjellësin rajonal. Në rast të dëmtimit eventual nga pakujdësia OE është i obliguar në afat sa më të shkurt të rikoperoj dëmtet në kosto të vetë buxhetore në mënyrë që vendbanimet përreth rrugës e cila do të ndërrtohet të mos mbesin pa shërbimet komunale. Llog në m ² me të gjitha shpenzimet.	m ²	0.00	0.10 €	0.00 €
2.3	Pastrimi, zhbllkimi dhe mirëmbajtja e lëtesave ekzistuese ujore në aksin e rrugës në të dy anët e rrugës.	m ²	0.00	0.10 €	0.00 €
Gjithsej: Pos 2					

3 PUNIMET TOKËSORE

Gërmimi dhe hapja e kanalit të kategorisë III-IV ,deri në thellësinë dhe me gjërësi të nevojshme për punë duke përcjellë të gjitha pikat gjeodezike dhe detaje sipas projektit të dirajnuar në profilin gjatësorë dhe tërthorë .

Në këtë pozicion përfshihet edhe hapja e kanaleve antenore , gërmimi dhe vendosja e lëtesave (tombinave) dhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Në çmim përfshihet edhe ngjeshja me cilindër brekkoce (papuçe vibruese) të pjesëve antenore dhe punimi i skarpalës. Dheut i tepër hartet në deponi më të afërta deri 5.0km largësi

Vrejtje: Sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryeri, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt

3.1	Punët me makineri (90%)	m ³	45.00	3.00 €	135.00 €
	Punët me doç (10%)	m ³	5.00	2.00 €	10.00 €
3.2	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës	m ³	20.00	2.00 €	40.00 €

Punimi i bazamentit (para mbushtjes) me rrafshim dhe ngjeshje, si dhe rregullimi i pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore të rrugëve sipas detaleve teknike të përfshira në projekt.

Mbushja , nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i me cilindër vibrues me prahë 12t deri në Ms=500kg/cm² në të gjitha pjesët e trasës ku është bërë germimi.

3.3	Plotësimi , mbushja dhe Nivelizimi e trasës së rrugës me bartje të dheut të zgjedhur deri në plotësimin e kriterëve të ngjeshjes sipas kriterëve teknike të specifikuar në përshkrimin teknik të projektit	m ³	20.00	2.50 €	50.00 €
-----	--	----------------	-------	--------	---------

Punimi i planimit dhe bankinave të rrugës dhe trotuarve me bartje të materialit shtrirje , rrafshim dhe ngjeshje me cilindër vibrues 18 tone sipas kushteve përgjithshme dhe teknike të specifikuar në projekt.

3.4	Punimi i planimit dhe bankinave	m ³	0.00	3.00 €	0.00 €
Gjithsej: Pos 3					235.00

4 PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)

Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtresës t=20 cm të cila i plotëson kushtet e parapara për tampion si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=600 kg/cm² . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkyese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës

4.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm	m ³	60.00	12.35 €	741.00 €
-----	---	----------------	-------	---------	----------

Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-31.5mm, me trashësi të shtresës t=10 cm, të cila i plotëson kushtet e parapara për tampion si dhe nivelizimi dhe ngjeshja për materialin e bankinave në të dy anët e rrugës me gjerësi (2 x 0.30 cm) dhe ramje 4% ngjeshja bëhet me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=800 kg/cm² . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkyese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.

4.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm	m ³	30.00	12.00 €	360.00 €
Gjithsej: Pos 4					1,101.00

5 PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA

Punimi i lëshesave , pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt . Në çmim është llogaritur hapja e kanalit dhe vendosja e rërës, furnizimi dhe vendosja e gypit armuar, duke duke përfshirë edhe kokën hyrëse dhe dalëse të lëshesës nga beton armuar sipas detajit teknik të prezentuar në projekt llog në m' me të gjitha shpenzimet

5.1	Lëshes Ø 400mm deri 10 m gjatësi	m'	0.00	10.00 €	0.00 €
-----	----------------------------------	----	------	---------	--------

5.2	Punimi i kanalit të hapur atmosferik për kullimin e ujërave atmosferik nga skarpatë dhe lëshesat me lartësi dhe gjeresi të ndryshueshme konform konfiguracionit të terrenit , të paraqitura në , profilet tërthore dhe gjatësore për secilin stacionazh	m'	0.00	0.10 €	0.00 €
Gjithsej: Pos 5					-

6 PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASPALTIT DHE BETONIT

6.1	Demolimi i kokave të pusetave ekzistuese, si dhe ngritja dhe punimi i kokave të reja , përfundimi me armaturë , si dhe inkastrimi i umazë metalike të kapakut të pusetë. Ngritja e kokës së pusetave bëhet në nivel me kufotën e asfaltit. Në çmim llogaritet edhe vendosja e kapakut të ri prej Gize DN 600 mm deri 4ft Llog për copë me të gjitha shpenzimet	copë	3.00	10.00 €	30.00 €
-----	--	------	------	---------	---------

6.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm AB16 me trashësi t=8,0cm , në çmim përfshihet edhe zgjerimi nëpër lthesa Vërejtje :Te mirren mostrat në vend dhe të bëhet ATESTI .METODA MARSHALL.	m ²	340.00	12.00 €	4,080.00 €
Gjithsej: Pos 6					4,110.00

REKAPITULIMI - ASFALTIMI E RRUGËS NË FSHATIN GJLLAREVE RIKHEVE STAPANICE ZABERGJE

1	PUNËT PARAPRAKE				0.00 €
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT				0.00 €
3	PUNIMET TOKËSORE				235.00 €
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)				1,101.00 €
5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA				0.00 €
6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASPALTIT DHE BETONIT				4,110.00 €
TOTALI ME TVSH					5,446.00 €

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM I ASFALTIMIT .RRUGËVE NË FSHATIN GJLLAREVE RIKHEVE STAPANICE ZABERGJE

1	ASFALTIMI I RRUGËS				5,446.00 €
TOTALI ME TVSH					5,446.00 €

2. PARAMASA PËR NDËRTIMIN E KANALIZIMIT NË FSHATIN GLLAREVE RIXHEVE STAPANICE ZABERGJE

2. PARAMASA PËR NDËRTIMIN E KANALIZIMIT NË FSHATIN GLLAREVE RIXHEVE STAPANICE ZABERGJE					
PUNËT PREGADITORE					
NR.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Gjithësej (€)
1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet kanalizimi sipas projektit detaj gjatë kohës së zgjatit punimet. llog në m ²	m ²	118.00	0.50 €	59.00 €
1.2	Punët parapergjitore, shënimu gjeodezik si dhe verifikimi i trasesë së vjetër të kanalizimit, në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, po ashtu të maten distancat dhe të mundësohet kyçja e kolektorve të vjetër në kolektorin e ri , kyçja dhe shkarkimi i gropave septike ekzistues në rrjetin e ri të kanalizimit sipas projektit dhe detaleve teknike. llog në m ² Matjet gjeodezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët e kryera të sjellen hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjeodet të licencuar.	m ²	118.00	0.50 €	59.00 €
1.3	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat, e ngurta ndërtimore, shkurret drunjtë e pyllëruar - në zonat ku do të kalojë traseja e kanalizimit . Pastrimi i tyre bëhet normal me rrjedhës e kanalizimit me gerësi 3m për ti mundësuar futjen normale të makinerisë për gërmim si dhe largimin e tyre në depozitë, Depozitë e caktion Investitorit. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rethojave dhe këthimin në gjendje të më parshme pas përfundimit të punimeve. llog në m ²	m ²	118.00	0.50 €	59.00 €
1.6	Demolimi i rrjetit ekzistues të vjetër, pastrimi i terrenit dhe krijimi i kushteve ndërtimore për instalimin e rrjetit të ri. llog në m ² me të gjitha shpenzimet	m ²	40.00	10.00 €	400.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET PREGADITORE					577.00 €
2. PUNËT E DHEUT					
2.1	Gërmimi dhe hapja e kanalit për tokë fushore të kategorisë III-IVnë thellësi prej 0.8 m' deri në thellësinë 5.30 m' për kanalizim fokal dhe gerësi të nevojshme për punë duke përcjellë të gjitha pikat gjeodezike sipas profilit gjatësorë dhe dispozitës së projektit . Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibrator pjesa e trases së kanalizimit. Vërejtje: Sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryesi, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Sqarim : Ky lloj e kategorisë së dheut përfshihet të gjithë zone ku kalon traseja e kanalizimit duke filluar prej Stacionazhes D.00 deri në përfundim të kanalizimit në stacionazhen e fundit.				
	Punët me makineri (90%)	m3	295.00	0.90 €	265.50 €
	Punët me dorë (10%)	m3	29.50	1.00 €	29.50 €
2.2	Gërmimi dhe hapja e dheut për tokë fushore të kategorisë II-VII duke llaparitur edhe depozitë e mbushur me materiale inertu për hapjen e pusetave të kanalizimit në bazë të detaleve , skicave të përfshirë në projekt.				
	Punët me makineri (90%)	m3	18.00	1.00 €	18.00 €
	Punët me dorë (10%)	m3	1.50	1.00 €	1.50 €
2.3	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së pusetave nga materiali guror para se të becohet kinezit(Bazamenti puseta) ,Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes t/v=250 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet të jetë i paizur me aleste paraprake dhe atë sipas normave dhe standardeve. Vërejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe të prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	1.00	5.00	5.00 €
2.4	Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim ±3cm, dhe 15 cm mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit , sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë vendosje së rërës të aplikohet gjeometria të përcaktuara në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në veprë. llog m3	m3	20.00	5.00 €	100.00 €

2.5	Largimin e ujërave nëntokësore të cilët shfaqen gjatë gërmimit të kanalit, të cilët pengojnë ecimin e punës në instalimin e rrjetit të kanalizimit. , Ulog me ore/pune me aprovimin e organit mbikëqyrës	ore/pune	0	5.00 €	0.00 €
2.6	Vendosja e trakës mbrojtëse sinjelizeuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjithë trasesë së rrjetit të kanalizimit , për ta indentifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.	m'	118	1.00 €	118.00 €
2.7	Mbushja dhe mbulimi e kanalit pas vendosjes së gypit me sasi të dheut të përgatitur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detajeve të përcaktuara në projekt për secilin pusët/stacionat, pastaj vendoset pjesa tjetër e dheut deri në mbushje përfundimtare të terrenit dhe kthimi në gjendje të mëparshme , dheu i topër largohet në deponin më të afërt deri në 15 km largësi.	m3	230.00	1.00 €	230.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET E DHEUT					767.50 €
3 PUNËT LATUESE (VENDOSJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT)					
3.1	Furnizimi dhe punimi i bazamentit të pusetave prej betoni C- 25/30 të armuar me klasë të armatures S-400/500 , si dhe punimi i kinezës së pusetave duke i dhënë ramjen e duhur në drejtim të rrjedhës së kolektorit sipas detajit teknik të prezentuar në projekt. Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit Ø800 mm nga betoni i parafabrikuar i papershlyeshëm nga uji. Kompania ekzekutuese është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar prej montimit të gypit mbulimit dhe vazhdon me lartësi të ngrihtë deri të kuota gjeodezike të përcaktuara në profilin gjatësor të projektit të përfshirë edhe lonuset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaç çimentoje me raport të rezetës 1:3.	copë	9	10.00 €	90.00 €
3.2	Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave nga materiali i betonit DN 800 mm mos depërtimin e ujërave atmosferike në pusët e kanalizimit fekal. Sipas detajit të prezentuar në projekt	copë	0	10.00 €	0.00 €
3.3	Vendosja e unazave për nivelizimin e depërtimit të gypit i cili futet në pusët betonit me dimensione sipas projektit , dhe mbështetë në kinezë për shkarkimin e kontrolluara të ujit kanalizimit në pusët, unaza në kinezë dhe në depërtimin e pusetës duhet përfunduar me llaç me raport 1:1 sipas skicës së projektit. Vërejtje : Gjate ekzekutimit të punimeve duhet patur kujdes që të ndërmerren të gjitha masa izoluese që parandalohet rrjedhja para se të futet në pusët ujë fekal dhe mos shkaktohen ndotje ambientale.				
	Unaza DN 250 mm	copë	6	9.00 €	54.00 €
3.4	Furnizimi dhe vendosja e gypave nga Materiali HDPE kualiteti PSH 8, përgjatë gjithë gjatësisë së trasesë së kanalizimit, duke përcjellur nivelimin dhe gjërësinë e ramjes në bazë projektit, me të gjitha elementet përcjellëse duke vendosur unaza nga goma ku lidhen gypat për të parandaluar lëvizjen e gypave dhe duke pamundësuar hyrjen e gjesendeve të ngurta të cilët bllokojnë gypin. Gjate ekzekutimit të projektit të respektohen detajet teknike të përfshira në prejen terthore dhe gjatësore pa ashtu të respektohen kuotat gjeodezike të parafshira projekt. Vërejtje : Punëtryesi pasi të fillojë vendosjen dhe instalimin e gypave duhet të dorëzojë atestet e materialeve konform specifikacionit teknik të projektit				
	GYP HDPE PSH 8 DN 200 mm	m'	118.00	9.0 €	1,062.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET LATUESE					1,206.00 €
REKAPITULIMI - NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË FSHATIN GLLAREVE RIKHEVE STAPANICË ZABERGIE					
1	GJITHËSEJ PUNIMET PREGADITORE				577.00 €
2	GJITHËSEJ PUNIMET E DHEUT				767.50 €
3	GJITHËSEJ PUNIMET LATUESE				1,206.00 €
TOTALI ME TVSH					2,550.50 €
1	Totali i rrugëve :				5,446.00 €
2	Totali i Kanalizimit :				2,550.50 €
Totali :					7,996.50 €

Menaxher i Projektit :

Menaxheri i Kontrates :

REA SHPK :



811242502

REKUP

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-25-889-5-3-5/C836

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuar.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontrakteton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njej lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit. Ekzekutimi i urdhrimit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

